



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të Ismet Bahtijarit, Sabit Januzit dhe Haxhi Shalës, më 25 tetor 2024, Trupi Gjykes caktoi të enjten, 14 nëntor 2024, si datë për fillim të gjykimit. Në fillim të seancës, Kryegjykatësja do të hapë gjykimin dhe Prokuroria do të lexojë aktakuzën ose një përmbledhje të saj dhe do të pyesë të akuzuarit nëse i kuptojnë akuzat. Kryegjykatësja do t'u japë mundësinë për të konfirmuar vetëdeklarimet e tyre fillestare të pafajësisë dhe më pas do t'i informojë për të drejtat e tyre përpara gjykatës.

Trupi Gjykes i caktoi Prokurorisë dy orë për deklaratën hyrëse. Pas Prokurorisë, Mbrojtja e Shalës dhe Januzit bënë me dije se dëshirojnë t'i bëjnë deklaratat hyrëse në këtë fazë të gjykimit. Mbrojtja e Bahtijarit bëri me dije se parapëlqen ta bëjë deklaratën hyrëse pas përfundimit të paraqitjes së provave nga Prokuroria. Kryegjykatësja i caktoi Mbrojtjes së Januzit një orë për deklaratën hyrëse dhe Mbrojtjes së Shalës 30 minuta për të.

Deklaratat hyrëse do të vijojnë të premten, 15 nëntor, në qoftë se është e nevojshme. Paraqitja e provave nga Prokuroria do të fillojë të hënë, 9 dhjetor në orën 9:30 paradite. Çdo mocion për të cilën duhet të merret vendim para fillimit të gjykimit duhet të dorëzohet më së voni deri më 1 nëntor. Trupi Gjykes bëri të ditur se mund të lëshojë vendim gojarisht mbi këto kërkesa para deklaratave hyrëse.

Duke pasur parasysh rëndësinë e parimit të procesit publik, Trupi Gjykes udhëzoi palët që t'i paraqesin deklaratat hyrëse në seancë publike sa më shumë që të jetë e mundshme.





Më 28 tetor 2024, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, gjykatëse Ekaterina Trendafilova, hodhi poshtë në tërësi mocionin e z. Haxhi Shala. Pasi Trupi Gjykses kishte bërë të ditur datat e mundshme për fillimin e gjykimit në këtë çështje gjyqësore, z. Shala kërkoi informacion në lidhje me disponueshmërinë e sallës së gjyqit për të minimizuar mundësinë e zgjatjes së panevojshme të gjykimit.

Kryetarja theksoi se korniza ligjore e Dhomave të Specializuara përcakton se i takon trupit gjykses përkatës që të caktojë seancat gjyqësore. Ajo theksoi se Trupi Gjykses kishte qartësuar se kërkesa e tij që Prokuroria dhe Mbrojtja të jenë në dispozicion në data të caktuara nuk është tregues për kohëzgjatjen e pritshme të gjykimit. Gjykatëse Trendafilova gjithashtu vuri në dukje se z. Shala nuk paraqiti argumente në lidhje me vonesat aktuale në proces dhe rikujtoi se korniza ligjore e Dhomave të Specializuara ofron garanci dhe mjete juridike të mjaftueshme me anë të të cilave mund të paraqiten shqetësimet e z. Shala në rast se ato në fakt materializohen.

Më 30 tetor, u publikua versioni i redaktuar publik i vendimit të Trupit Gjykses mbi kërkesën e z. Bahtijari për nxjerrje të disa materialeve për një ekspert për mundësimin e një vlerësimi mjekësor të z. Bahtijari. Trupi Gjykses theksoi se në kërkesën e saj, Mbrojtja nuk saktësoi bazën ligjore për nxjerrje të materialit, dhe se kërkesa e saj ishte e formuluar gjerësisht dhe nuk faktohej mjaftueshëm. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e hodhi poshtë kërkesën dhe ftoi Mbrojtjen e Bahtijarit të dorëzonte një kërkesë të bazuar si duhet për nxjerrje të materialit. Trupi Gjykses i dha Mbrojtjes gjithashtu udhëzime për strukturë dhe përmbajtje relevante për këso lloj kërkesash.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, gjashtë dëshmitarë dhanë dëshmi këtë javë. Sipas përmbledhjes së lexuar nga ZPS-ja, Fatmir Sopi ishte anëtar i UÇK-së i përfshirë në organizimin e strukturave të UÇK-së në rajonin e Gollakut brenda zonës operative të Llapit dhe pati rol kyç në krijimin e Brigadës 153. Ai dha dëshmi kryesisht pa masa mbrojtëse në lidhje me krijimin, strukturën, stërvitjen dhe operacionet e Brigadës 153. Pas dëshmisë së z. Sopi, tre dëshmitarë





dhanë dëshmi me masa mbrojtëse dhe kryesisht në seancë private. Disa prej tyre dhanë dëshmi nëpërmjet videolidhjes.

Dje pasdite, dha dëshmi Haxhi Mazreku. Ai ishte dëshmitari i 102-të që ka dëshmuar në gjyq deri më tani dhe e përfundoi dëshminë e dhënë publikisht sot paradite. Pas tij, Nuredin Ibishi rifilloi me dhënien e dëshmisë së tij që filloi javën e shkuar, duke iu përgjigjur pyetjeve nga Mbrojtja.

Seanca e ardhshme në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* është caktuar për të hënë, 4 nëntor, duke filluar në 9:00 paradite.

